



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DECAN  
OPSTINA DECANI



Komiteti për Komunitete  
02. Nr. VIII  
Deçan, dt. 13.09.2024

## PROCESVERBAL

Mbledhja e tetë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 13.09.2024.  
Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, PK-ja, OSBE, UNMIK-u.  
Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:
2. Raport nga ZLK-ja:
3. Ftesë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa: aprovimi i buxhetit për vitin e ardhshëm, përfshirja e propozimeve nga komunitetet në planifikimin e buxhetit.
4. Diskutim me z. Edmond Dushi rreth aktiviteteve me OSBE-në.
5. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.  
Procesverbali miratohet një zëri pa asnjë vërejtje nga të gjithë anëtarët e Komitetit.

### II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinoviç, Udhëheqës i ZLK-së, raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pasur një kërkesë nga komuniteti, familja Jollaj ka kërkuar ndihmë për kyçe në sistemin e kanalizimit, ku te njëjtëve ju është ndihmuar nga ZKK për hartimin e kësaj kërkesë dhe adresimin e saj tek zyra përkatëse.

III. Raport nga Drejtoresha për Buxhet dhe Financa Znj, Dafina Cacaj:

Sa i përket raportit Drejtoresha për Buxhet dhe Financa Znj, Dafina Cacaj: e njëjta i njoftoj te pranishmit për Buxhetin e Komunës së Deçanit vitin 2025/2027.

Buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2025 parashihet të jetë 14,401,935.00 €.

Drejtoresha Znj, Dafina Cacaj tha se gjate viteve paraprake janë realizuar shumë projekte për qytetarët nga komunitetit jo shumicë siç është asfaltimi dhe kyçja ne rrjetin e kanalizimit në lagjen Pemishte, Gramaçel dhe Prapaqan, projekte këto të bashkë financuara nga nivelin qendror me participim edhe nga Komuna e Deçanit.

Shkelzen Berisha Kryesues i Komitetit të Komuniteteve kërkoj te informohet rreth një kërkesë te bere për lagjen Pemishte për ndërtimin e një muri mbrojtës ne rrugën kryesore te kësaj lagjeje.

Drejtoresha Znj, Dafina Cacaj tha se do ti dërgojmë zyrtaret kompetent nga Drejtoria për Shërbime Publike që të bëjnë vlerësimin e gjendjes në terren.

Drejtoresha i inkurajoj përfaqësuesit e komuniteteve jo shumice pranë Komitetit për Komunitete që të paraqesin kërkesa konkrete dhe se te njëjtat do te shqyrtohen.

IV. Diskutim me z, Edmond Dushi rreth aktiviteteve me OSBE-në.

Edmond Dushi i njoftoj te pranishmit rreth aktiviteteve qe janë ne vazhdimësi këtë vit e qe organizohen dhe sponsorizohen nga OSBE, aktiviteti pasues është vizita neper teren ne vendbanimet me komunitete ne Komunën e Deçanit.

Pjesë e këtyre vizitave do te jene koleget nga Komuna e Pejës me qellim te shkëmbit te përvojave te ndryshme nga terreni.

V. Të ndryshme: Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-j kërkoj të informohet nga z, Shaban Pejçinoviç nëse ekziston ndonjë initiative rreth ndarjes se ndonjë ndihme ne prag te stinës se dimrit me material për ngrohje për pjesëtarët e komunitetit jo shumice. Shaban Pejçinoviç tha se deri tani nuk ka ndonjë initiative por me siguri do te ketë ne ditët ne vazhdim.

Kryesuesi i falënderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:  
Artan Ismajlaj

Kryesuesi i mbledhjes  
Shkelzen Berisha